Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Developement

Analiza e Tregut të Vezëve dhe Mishit të Pulës

Nëntor, 2016

DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE DHE STATISTIKAVE BUJQËSORE

Analiza e Tregut të Vezëve dhe Mishit të Pulës

Tetor, 2016

Tregu i vezëve dhe mishit të pulës

1. Struktura e shpezëve dhe madhësia e fermave
2. Prodhimtaria vendore për vezë dhe mish pule
3. Zhvillimi i tregtisë ndërkombëtare
    3.1. Importi i vezëve dhe mishit të pulës
    3.2. Eksporti i vezëve dhe mishit të pulës
    3.3. Bilanci tregtar për vezë dhe mish pule
4. Çmimet e tregut
5. Kosto e prodhimit të vezëve
6. Mbështetja e sektorit të shpeztarisë
    6.1. Pagesat direkte për shpeztari
    6.2. Përkrahja e shpeztarisë përmes masave të zhvillimit rural
7. Konkluzione

Tregu i vezëve dhe mishit të pulës

Sektori i shpeztarisë në Kosovë është kryesisht i orientuar në prodhimtari të vezëve, por kohëve të fundit ka filluar të zhvillohet edhe prodhimtaria e mishit të pulës.

Prodhimtaria vendore e vezëve arrin të mbuloj rreth 98% të nevojave për konsum, me një konsum mesatar për kokë banori prej 200 vezë në vit, 197 prej të cilave janë siguruar nga prodhimtaria vendore.

Prodhimtaria vendore e mishit të pulës aktualisht arrin të mbulojë rreth 5% të nevojave për konsum. Konsumi mesatar për kokë banori vlerësohet të jetë rreth 20 kg në vit, ndërsa vetëm rreth 1 kg mish pule për kokë banori sigurohet nga prodhimtaria vendore.

Importi i vezëve në masën më të madhe realizohet kryesisht nga Shqipëria dhe Maqedonia ndërsa importi i mishit të pulës nga Shtetet e Bashkuara dhe Brazili. Përkundër importit, eksport nuk ka në vazhdimësi dhe kjo bënë që Kosova ashtu siç ka bilanc tregtar negativ në përgjithësi të ketë edhe për vezë dhe mish pule. Bilanci për vezë krahasuar me atë për mish pule është tejet simbolik duke qenë se Kosova plotëson kërkesat për konsum të vezëve në nivel shumë të kënaqshëm.

1 Struktura e shpezëve dhe madhësia e fermave

Në Kosovë, në vitin 2014 sipas të dhënave të Regjistrimit të Bujqësisë ishin gjithsej 67,150 ekonomi bujqësore që kishin shpezë dhe numri i përgjithshëm ishte 2,691,831 shpezë. Pjesa më e madhe e ekonomive bujqësore kanë më pak se 50 shpezë, afër 10,000 ekonomi bujqësore kanë prej 50 deri në 149 ndërsa vetëm një numër i vogël kanë më shumë se 150 shpezë. Nga gjithsej numri i shpezëve, 63% (1,703,954) janë pula për vezë, 26% (686,643) janë zogj, pula dhe gjela të tjerë, 7% (193,852) janë brojlerë dhe pjesa tjetër prej 4% janë shpezë të tjera përfshirë bibat, rosat dhe patat, pulat afrikane, pëllumbat etj.

Figura 1: Struktura e shpezëve në vitin 2014



Burimi: Regjistrimi i bujqësisë 2014

Në vitin 2014 ishin 1,700 ekonomi bujqësore që kishin brojlerë. Numri më i madh i brojlerëve është në regjionin e Gjilanit (40%) pasuar nga Ferizaji (17%), Prishtina (11%) dhe 4 regjionet e tjera me 32%. Numri mesatar i brojlerëve për ekonomi bujqësore është 114 krerë dhe ndryshon varësisht nga regjioni nga 44 krerë, sa është në regjionin e Prishtinës deri në 282 krerë për ekonomi bujqësore në regjionin e Gjilanit, që njëherit është edhe regjioni që ka numrin më të madh të brojlerëve. Përkundër asaj se regjioni i Prishtinës rradhitet i treti sa i përket numrit të brojlerëve, numri i madh i ekonomive bujqësore që kanë brojlerë bënë që mesatarja në këtë regjion të jetë më e ulëta. Ngjajshëm me Prishtinën, mesatare të ulët ka edhe regjioni i Pejës me 56 krerë për ekonomi bujqësore.

Figura 2: Numri i brojlerëve sipas regjioneve (majtas) dhe numri mesatar i brojlerëve për ekonomi bujqësore (djathtas), në vitin 2014



Burimi: Regjistrimi i bujqësisë 2014

Gjithsej numri i pulave për vezë në vitin 2014 ishte 1,703,954 krerë me numër mesatar prej 33 krerë për ekonomi bujqësore. Mesatarja më e ulët ishte në regjionin e Pejës me 24 krerë, regjion në të cilin është edhe numri më i vogël i pulave krahasuar me regjionet e tjera, ndërsa mesatarja më e lartë ishte në regjionin e Gjakovës me 67 krerë, regjion i cili është në vend të dytë me 18% të numrit të përgjithshëm të krerëve pas Prishtinës e cila kryeson me 22%.

Figura 3: Numri i pulave për vezë sipas regjioneve (majtas) dhe numri mesatar i pulave për vezë për ekonomi bujqësore (djathtas), në vitin 2014



Burimi: Regjistrimi i bujqësisë 2014

Shëndrrimi i numrit të shpezëve në njësi blegtorale për të bërë krahasimin e fermave sa i përket njësive blegtorale bëhet duke përdorur koeficientet e njësisë blegtorale. Në Kosovë numri i njësive blegtorale për shpezë është 49,033 që rezulton nga numri i përgjithshëm i shpezëve prej 2,691,831. Nëse shikohet numri i NjB rreth 49% të numrit të përgjithshëm e përbëjnë pulat për veze, 42% kategoria zogj, pula dhe gjela të tjerë dhe pjesën tjetër prej 9% kategoritë e tjera. Detajet mund të shihen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1: Numri i njësive blegtorale sipas kategorive të shpezëve

	Numri i shpezëve	Koeficientët e NjB	Numri i NjB
Brojler	193,852	0.007	1,357
Pula për vezë	1,703,954	0.014	23,855
Zogj, pula dhe gjela të tjerë	686,643	0.030	20,599
Biba	45,444	0.030	1,363
Rosa dhe pata	18,237	0.030	547
Shpezë të tjera (pula afrikane, pëllumba etj)	43,701	0.030	1,311
Gjithsej	**2,691,831**		**49,033**

Burimi: DAESB bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë 2014

2 Prodhimtaria vendore për vezë dhe mish pule

Në vitin 2014 prodhimi i vezëve në Kosovë vlerësohet të jetë rreth 357 mil. copë ku më shumë se dy të tretat e prodhimit vijnë nga fermat komerciale ndërsa pjesa tjetër nga fermat më të vogla kryesisht ato familjare.

Mishi i pulës ka vlera të larta ushqyese dhe është lehtë i tretshëm në organizëm, është mish që ka përmbajtje më të ulët të yndyrës në krahasim me llojet e tjera të mishit dhe burim i rëndësishëm i proteinave. Ai është i pasur më lloje të

ndryshme të vitaminave si vitamin B3, B6, B7, B12 të cilat janë të rëndësishme për funksionimin e organizmit, për imunitet, ruajtje të nivelit të sheqerit në gjakë etj. Gjithashtu ka përmbajtje të hekurit dhe zinkut e që e bënë këtë produkt mjaftë të rëndësishëm për plotësimin e nevojave ditore me këta përbërës.

Gjatë zgjedhjes së mishit të pulës për konsum si edhe çdo produkt tjetër para se gjithash duhet të shikohet cilësia e njëkohësisht edhe prejardhja e atij produkti në mënyrë që ushqimi të jetë i sigurt, duke qenë se ka ndikim direkt në të ushqyerit e shëndetshëm.

Prodhimi i mishit të pulës vlerësohet të jetë rreth 2,000 ton në vit duke marr parasysh faktin se sektori i shpeztarisë aktualisht është i orientuar kryesisht në prodhimtarinë e vezëve për konsum dhe prodhimin e zogëzave kurse prodhimtaria e mishit të zogut është në fazën e konsolidimit.

Kompania më e madhe në Kosovë për prodhimin e mishit të pulës "Konsoni" aktualisht ka therrtore me kapacitet për therrje deri në 1,500 ton/vit dhe janë në ndërtim e sipër të një thertoreje me kapacitet therrës deri në 10,000 ton/vit. Kjo do të ketë ndikim që në të ardhmen të rritët prodhimtaria vendore e njëkohësisht edhe shkalla e mbulueshmërisë së kërkesave për konsum.

3 Zhvillimi i tregtisë ndërkombëtare

Kosova për të mbuluar nevojat vendore për konsum të vezëve importon një sasi të vogël të vezëve duke marr parasysh faktin se prodhimtaria vendore mbulon pothuajse tërë tregun, ndërsa sa i përket eksportit, në periudhën '12-'15, eksport të vezëve ka pasur vetëm në vitin 2014.

Për dallim nga situata në tregun e vezëve, vlera e tregtisë ndërkombëtare në rastin e mishit të pulës është mjaftë e madhe duke ditur që prodhimtaria vendore mbulon një pjesë shumë të vogël të tregut. Duke qenë se përmbushja e nevojave konsumuese nga prodhimtaria vendore e mishit të pulës është e ulët, Kosova në vazhdimësi ka importuar, ndërsa në periudhën '12-'15 përkatësisht në vitin 2012 ka eksportuar një sasi tejet simbolike prej 1.5 tonë në Shqipëri.

3.1 Importi i vezëve dhe mishit të pulës

Në periudhën '12-15' importi i vezëve ka shënuar rënie të vazhdueshme nga rreth 20.7 mil. vezë sa ishte në vitin 2012 në vetëm 2.5 mil. vezë në vitin 2015. Vlera mesatare e importit të vezëve në periudhën '12-'15 ka qenë 635.7 mijë €. Importi në këtë periudhë kryesisht është realizuar nga Shqipëria dhe Maqedonia me mbi 85% ndërsa pjesa tjetër nga vende të tjera si Greqia, Turqia, Rumania, Bullgaria, Argjentina, Italia etj. Për dallim nga vitet e tjera në vitin 2015 ka pasur

rritje të importit të vezëve nga Argjentina e cila së bashku më Shqipërinë përbënin 91% të sasisë totale të importuar në këtë vit.

Figura 4: Importi i vezëve '12-'15 në vlerë ('000 €) dhe sasi (tonë)



Burimi: ASK përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Në periudhën '12-'15 sasia mesatare e importit të mishit të pulës ka qenë 34,357 tonë, sasia më e lartë ka qenë në vitin 2015, përkatësisht 7.5% më e lartë sesa mesatarja gjatë periudhës '12-'15, ndërsa ajo më e ulta ka qenë në vitin 2012 me 31,899 tonë. Në këtë periudhë rreth 70% e sasisë së mishit të pulës është importuar nga Shtetet e Bashkuara dhe Brazili ndërsa nga vendet e tjera vlenë të përmendet Italia dhe Gjermania, vende nga të cilat është importuar rreth 9% dhe pjesa tjetër nga vendet e tjera.

Figura 5: Importi i mishit të pulës '12-'15 në vlerë ('000 €) dhe sasi (tonë)



Burimi: ASK përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3.2 Eksporti i vezëve dhe mishit të pulës

Kosova sa i përket eksportit, vezë dhe mish të pulës nuk është se ka eksportuar vazhdimisht. Gjatë periudhës '12-'15 eksport të vezëve ka pasur vetëm në vitin 2014 dhe atë në sasi prej 120 kg apo rreth 2,000 copë vezë. Kjo sasi e vezëve është eksportuar në Shqipëri.

Jo shumë ndryshe nga situata sa i përket eksportit të vezëve, qëndron edhe situata lidhur me eksportin e mishit të pulës. Duke qenë se prodhimtaria vendore e

mishit të pulës është në fazë të konsolidimit dhe përmbushja e nevojave vendore është në nivel tejet të ulët, eksport të mishit të pulës gjatë periudhës '12-'15 ka pasur vetëm në vitin 2012, ku në Shqipëri është eksportuar një sasi prej 1.5 tonë me çmim rreth 2.70 €/kg.

3.3 Bilanci tregtar për vezë dhe mish pule

Duke qenë se eksport të vezëve ka pasur vetëm në vitin 2014, Kosova në vazhdimësi ka pasur bilanc tregtar negativ. Vlera e bilancit tregtar për vezë është zvogëluar dukshëm në periudhën '12-'15, e kjo jo për faktin se ka ndryshuar raportin në mes të eksportit dhe importit por për faktin se është zvogëluar sasia e importuar. Vlera e bilancit tregtar në vitin 2015 është zvogëluar në 220 mijë € nga 1.2 mil. € sa ishte në vitin 2012. Ky përmirësim i vlerës ka qenë gradual ku në vitin 2013 vlera ishte 650 mijë € ndërsa në vitin 2014, 480 mijë €.

Figura 6: Bilanci tregtar për vezë '12-'15, në '000 €



Burimi: ASK përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Situata në tregtinë e jashtme në rastin e mishit të pulës nuk është e favorshme duke marr parasysh faktin se vazhdimisht importohet sasi e konsiderueshme e mishit të pulës, duke qenë se prodhimtaria vendore është në nivel të ulët.

Në periudhën '12-'15 vlerë më të madhe negative të bilancit tregtar ka pasur në vitin 2013, përkatësisht 39,228 mijë € duke pasuar me ulje në vitet 2014 dhe 2015.

Figura 7: Bilanci tregtar për mish të pulës '12-'15, në '000 €



Burimi: ASK përpunuar nga DAESB-MBPZHR

4 Çmimet e tregut

Shitja e vezëve në tregun e Kosovës bëhet kryesisht në paketime prej 30 copë. Kohëve të fundit ka filluar të shtohet edhe shitja e vezëve në paketime më të vogla që nuk ishte praktikë e viteve të mëhershme.

Në periudhën '12-'15 çmimi mesatar ka qenë 2.65 €/30 ve, çmimi më i ulët ishte në vitin 2015 (2.23 €), ndërsa ai më i larti në vitin 2012 (2.78 €).

Në tregun e Kosovës pjesa më e madhe e mishit të pulës është nga importi, andaj çmimet në figurën më poshtë janë çmime mesatare në treg duke marr parasysh mishin e pulës vendor edhe atë të importuar. Çmimi mesatar në periudhën '12-'15 ishte 2.67 €/kg, ndërsa në vitin e fundit çmimi ishte 2.61 €/kg apo 2% me i ulët sesa mesatarja '12-'15.

Figura 8: Çmimi i vezëve (€/30 copë) (majtas) dhe mishit të pulës (€/kg) (djathtas), '12-'15



Burimi: ASK, Indeksi i çmimeve të prodhimt dhe çmimet në bujqësi 2010-2015; Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit 2002-2015

Në vitin 2015, çmimi për blerjen e një pule fshati ishte më i larti shikuar në periudhën '12-'15. Gjatë kësaj periudhe mesatarja e çmimit ishte 9.46 € apo 8% më e ulët sesa çmimi në vitin 2015. Për dallim nga pulat në ferma komerciale, çmimi i pulave të fshatit është rreth 4 herë më i lartë dhe kjo varet edhe nga viti të cilit i referohemi duke qenë se në vitin 2015 ai ishte 5 herë më i lartë sesa për pula ferme.

Pula e fermës në periudhën '12-'15 është shitur me çmim mesatar prej 2.20 €. Çmimi më i ulët ishte në vitin 2015 me 2.06 €, apo 6.4% më i ulët krahasuar me mesataren gjatë kësaj periudhe, ndërsa çmimi më i lartë ishte në vitin 2014 (2.33 €).

Figura 9: Çmimi për pulë fshati (majtas) dhe pulë ferme (djathtas) '12-'15, €/copë



Burimi: ASK, Indeksi i çmimeve të prodhimt dhe çmimet në bujqësi 2010-2015

5 Kosto e prodhimit të vezëve

Në Kosovë kostoja e prodhimit të vezëve është më e lartë krahasuar me vendet e tjera duke marr parasysh faktin se madhësia e fermave është e vogël si dhe teknologjia është e vjetruar. Nëse marrin një fermë me 3,600 pula për vezë, të ardhurat që kjo fermë mund të realizoj nga aktiviteti i saj gjatë një viti janë 86.6 mijë €. Këto të ardhura realizohen nga shitja e vezëve, shitja e pulave pas përfundimit të ciklit të prodhimit të vezëve si dhe shitja e plehut të shtallës.

Tabela 2: Kosto e prodhimit të vezëve në fermë me 3,600 krerë

Ferma me 3,600 krerë	Vlera në €
Të ardhurat	
Ve	81,420
Pula të amortizuara	4,061
Pleh shtalle	1,170
Totali i të ardhurave	**86,651**
Shpenzime variabile	
Pula vojse (18 javëshe)	16,200
Koncentrat	48,092
Ambalazhi (30 ve)	1,770
Kuti kartoni (360 ve)	1,475
Energji elektrike	700
Ujë	200
Shpërndarja e vezëve	1,062
Shpenzime veterinere	360
Shpenzimet e therrjes	338
Totali i shpenzimeve variabile	**70,198**
Të ardhurat bruto	**16,453**
Shpenzime fikse	
Fuqia punëtore	2,400
Amortizimi vjetor	1,343
Totali i shpenzimeve fikse	**3,743**
Të ardhurat neto	**12,710**
Të ardhurat neto plus subvencionet	**14,510**
Kosto e prodhimit për një ve	**0.07**

Burimi: MBPZHR-DAESB

Prodhimtaria mesatare për krerë është rreth 295 vezë në vit. Çmimi mesatar i vezëve është marr 2.30 €/pako (30 ve), ndërsa shitja e pulave është llogaritur me çmim prej 1.20 €/krerë dhe është marr parasysh edhe një sasi e humbjes prej 6% nga total i pulave të cilat për arsye të ndryshme mund të mos arrijnë të përfundojnë ciklin e plotë të prodhimit të vezëve dhe të mund të shiten si pula të amortizuara.

Shpenzimet variabile marrin pjesë 81% në të ardhurat totale duke rezultuar me të ardhura bruto prej 16,453 €. Në kuadër të shpenzimeve rreth 70% janë shpenzime për ushqim dhe 23% për blerjen e pulave vojse (18 javëshe), ndërsa pjesën tjetër e përbëjnë shpenzime të tjera si: shpenzime komunale, ato veterinere dhe për therrje si dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me paketim dhe shpërndarje.

Shpenzimet fikse marrin pjesë 4% në të ardhurat totale, duke bërë që në totalin e të ardhurave, të ardhurat neto të marrin pjesë 15%. Nëse të ardhurave neto u shtohen edhe subvencionet atëherë të ardhurat neto rriten për 1,800 € duke marr parasysh faktin se fermat që kanë në mes të 2,400 deri në 10,000 pula vojse mund të përfitojnë 0.50 €/krerë nga programi i pagesave direkte i cili hartohet nga MBPZHR dhe implementohet nga Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë.

Bazuar në shpenzimet variabile si dhe shpenzimet fikse, kosto e prodhimit për një ve është 0.07 €.

Duke marr për bazë faktin se numri i pulave vojse në vitin 2014 ishte 1,703,954 krerë dhe nëse një punëtor me orar të plotë të punës mund të kujdeset për 3,600 krerë, rezulton se në sektorin e shpeztarisë-pulave vojse punojnë rreth 470 persona me orar të plotë të punës, qofshin ata me pagesë apo edhe punëtor që punojnë në fermat e tyre. Nëse numri i pulave vojse rritet për 36,000 krerë kjo do të ndikonte që të krijoheshin 10 vende te reja pune.

6 Mbështetja e sektorit të shpeztarisë

6.1 Pagesat direkte për shpeztari

Subvencionimi i shpeztarisë përmes pagesave direkte ka filluar për herë të parë në vitin 2013. Pagesa për njësi ka ndryshuar varësisht nga numri i pulave në fermë. Aplikuesit të cilët në fermën e tyre kanë pasur prej 2,400-10,000 pula vojse janë mbështetur me nga 0.50 €/krerë, ata që kanë pasur pula prej 10,000-20,000 me nga 0.40 €/krerë dhe ata që kanë pasur numër të pulave mbi 20,000 me nga 0.30 €/krerë. E njëjta mënyrë e subvencionimit ka vazhduar edhe në vitin 2014 dhe 2015.

Në vitin 2013[1] nga gjithsej 61 aplikues sa ishin, kanë përfituar 58 prej tyre apo 95%. Numri i pulave ka qenë 567,996 krerë ndërsa shuma e pagesave të realizuara ka qenë 240,305 €. Bazuar në numrin e krerëve regjioni në të cilin sektori i shpeztarisë është mbështetur më së shumti në vitin 2013 ka qenë regjioni i Pejës me 43% pasuar nga Prizreni me 23%, Prishtina 16% dhe pjesa tjetër prej 18% në regjionet e tjera.

Në vitin 2014 edhe pse numri i përfituesve është rritur në 59, përqindja e refuzimit është rritur nga 5% sa ishte në vitin 2013 në 8% në vitin 2014. Krahasuar me vitin 2013, numri i krerëve të subvencionuar është zvogëluar për 7%, ndërsa shuma e pagesës për 4%. Pjesa më e madhe e pulave apo 29% kanë qenë në regjionin e Gjakovës, pasuar nga Prishtina me 21%, Prizreni me 17%, Peja me 13%, si dhe pjesa tjetër prej 20% në regjionet e tjera.

Në vitin 2015 janë mbështetur 57 fermerë me gjithsej 210,868 €. Kjo shumë është rreth 9% më e ulët sesa në vitin 2014 edhe pse numri i fermerëve përfitues ka rënë për vetëm 2 fermerë.

Në vitin 2016 subvencionimi do të bëhet për pulë vojse në të gjitha fazat e prodhimtarisë aktive të vezëve sipas madhësisë së tufës. Këtë vit subvencionimi i pulave vojse është ndarë vetëm në dy klasa, dhe përfitues të mundshëm janë fermat që kanë së paku 2,000 pula vojse. Subvencionimi për fermat që kanë 2,000-10,000 pula vojse do të 0.50 €/krerë, ndërsa fermat që kanë mbi 10,000 pula vojse do të subvencionohen 0.40 €/krerë. Buxheti i planifikuar për vitin 2016 për pagesa direkte për pula vojse është 210,000 €.

[1] Në vitin 2013 regjioni i Pejës dhe Gjakovës janë së bashku

6.2 Përkrahja e shpeztarisë përmes masave të zhvillimit rural

Sektroi i vezëve dhe mishit të pulës mbështetet në kuadër të masës **101 – Investimi në asete fizike të ekonomive bujqësore**. Ndër objektivat e përgjithshme të kësaj mase janë: rritja e aftësisë konkuruese dhe zëvendësimi i importit, krijimi i vendeve të reja të punës, përkrahja e fermerëve që të përafërojnë aktivitetin e tyre me rregullat e BE-së, përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror si dhe adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes përdorimit të energjisë së ripërtërishme.

Si objektiva specifike kryesore që kanë të bëjnë me sektorin e vezëve dhe mishit të pulës janë: zgjerimi i kapaciteteve dhe rritja e prodhimtarisë në fermat e specializuara, përmirësimi i cilësisë, pajisja e fermave me pajisje te reja dhe mekanizëm modern dhe krijim i lidhjeve më të mira në mes të prodhuesve dhe blerësve të prodhimeve të tyre.

Përveç kritereve të përbashkëta të pranueshmërisë përfituesit në sektorin e shpeztarisë duhet të përmbushin edhe disa kritere të veçanta të pranueshmërisë.

Për investime në sektorin e rritjes së brojlerëve, aplikuesit nuk janë të obliguar të kenë zogj në momentin e aplikimit, por para kërkesës për pagesën e fundit duhet të kenë së paku 5,000 zogj pule dhe të dëshmojnë këtë me dokumente përkatëse dhe me pranin e tyre në shtallë.

Për investime në sektorin e vezëve aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë 5,000 pula vojse në prodhimtari aktive të vezëve dhe të regjistruara në Regjistrin e Fermës si dhe aplikantët që aplikojnë për ndërtim të fermës së vezëve duhet që në projektin e tyre të përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj.

Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme brenda kësaj mase është 10,000 € ndërsa vlera maksimale 100,000 €. Përkrahja publike është 60% e shpenzimeve të pranueshme të investimit ndërsa përkrahje shtesë prej 5% jepet për investime në zona malore si dhe 5% për fermerë të rinj (më të rinj ose 40 vjeç).

Për investime që kanë të bëjnë me ndërtimin e shtallave, shpenzimet për arkitekt, inxhinier, leje dhe licenca të ndryshme janë të pranueshme deri në 7% të shpenzimeve të pranueshme të investimit ndërsa shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit apo projekt propozimit nuk mund të tejkalojnë më shumë se 3% të shpenzimeve të pranueshme.

Në vitin 2016 buxheti i ndarë për mbështetje të sektorit të mishit të shpezëve është 500,000 € ndërsa për sektorin e vezëve 300,000 €.

Sektori i shpeztarisë përkrahet edhe në kuadër të masës **103 – Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësor**. Në kuadër të kësaj mase, shpeztaria hyn në kuadër të përkrahjes që jepet për sektorin e përpunimit të mishit, përkatësisht për

thertoret dhe ndërmarrjet për përpunimin e mishit.

Kjo masë ka për qëllim që të ndihmohet industria e përpunimit të mishit në aspektin e implementimit të standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së që kanë të bëjnë me higjienën, sigurin ushqimore, mirëqenien e kafshëve dhe ruajtjen e mjedisit; futje e linjave të reja të përpunimit të mishit; diversifikimin e prodhimeve të mishit; modernizim të thertoreve; përmirësim të marketingut dhe përmirësim të menaxhimit të mbetjeve.

Aplikuesit që të jenë përfitues në kuadër të kësaj mase, përveç kritereve të përbashkëta të pranueshmërisë duhe të plotësojnë edhe kriteret e veçanta për sektorin e përpunimit të mishit, ku varësisht nga shkalla e kategorizimi të ndërmarrjes nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës në kategoritë A, B, C dhe D varet edhe investimi i pranueshëm.

Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme brenda kësaj mase është 30,000 € ndërsa vlera maksimale 400,000 €. Përkrahja publike është 50% e shpenzimeve të pranueshme të investimit ndërsa përkrahje shtesë prej 10% jepet për investime që kanë të bëjnë me trajtimin e mbetjeve.

Shpenzimet për arkitekt, inxhinier, leje dhe licence të ndryshme janë të pranueshme deri në 7% të shpenzimeve të pranueshme të investimit por jo më shumë se 15,000 € ndërsa shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit janë të pranueshme deri në 3% të shpenzimeve të pranueshme por jo më shumë se 5,000 €.

Buxheti i ndarë në vitin 2016 për sektorin e përpunimit të mishit është 1,400,000 €.

7 Konkluzione

Nga të gjitha të dhënat e përdorura në këtë analizë mund të themi se Kosova sa i përket prodhimtarisë së vezëve dhe mbulimit të tregut qëndron mjaft mirë dhe niveli i përmbushjes së nevojave për konsum është mjaft i kënaqshëm. Rol të rëndësishëm në zhvillimet e viteve të fundit luan edhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e cila përmes politikave mbështetëse po ndikon në rritjen e investimeve dhe zgjerimin e kapaciteteve prodhuese. Duke qenë se çdo herë buxheti i ndarë për mbështetjë është rritur, në vitet e ardhshme me investime të vazhdueshme Kosova do të mund të rriste edhe më tej prodhimtarinë dhe të plotësonte nevojat për konsum duke bërë kështu që të mos ketë nevojë që të importohet fare.

Për dallim nga situata më vezë, sektori i mishit të pulës është në zhvillim e sipër, përmbushja e nevojave konsumuese është në nivel të ulët dhe dominues në treg është prodhimi i importuar. Edhe në këtë sektor, investimet që po bëhen në ngritje të fermave, thertoreve por edhe në kompani që merren me përpunim të mishit do ndikojnë në rritje të prodhimtarisë dhe dal ngadal edhe në zëvendësim të nevojës për import.

Përveç ndikimit direkt në zhvillim të prodhimtarisë, investimet dhe zhvillimi i sektorit të shpeztarisë kontribuojnë edhe në rritje të numrit të të punësuarve qofshin ata anëtar të familjes që angazhohen në fermat e tyre apo edhe të punësuar të rregullt me pagesë. Rritja e numrit të personave të punësuar ndikon në rritjen e të ardhurave në familje dhe përmirësimin e standardit jetësor të familjeve kosovare.